



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

RREGULLORE
E
BULETINIT SHKENCOR TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" KORÇË

Miratuar me Vendimin nr. 194, datë 26 / 03 / 2025, të Senatit Akademik të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë

Neni 1

Buletini Shkencor

1. Buletini Shkencor i Universitetit “Fan S. Noli” (UNIKO) është periodik shkencor i njohur nga institucioni përgjegjës për certifikimin e periodikëve shkencore të Republikës së Shqipërisë.
2. Buletini Shkencor është botim periodik i regjistruar me numër serie ISSN 2078-7111 dhe on line me numër serie 3080-0447. Si vit i fillimit të botimit të tij njihet viti 1996.
3. Buletini Shkencor është botim i vetë Universitetit “Fan S. Noli”. Ai ka si funksion kryesor nxitjen, zhvillimin, promovimin dhe vlerësimin e veprimtarisë kërkimore, shkencore dhe botuese të universitetit si institucion i arsimit të lartë.
4. Parimi themelor i Buletinit Shkencor është cilësia akademike, profesionalizmi dhe etika në kërkim. Ai boton punime origjinale të shkruara në gjuhën shqipe ose angleze dhe synon përcjelljen e njohurive të reja të kërkimit shkencor të aplikuar.
5. Buletini Shkencor botohet dy herë në vit në trajtën hard copy dhe online në serinë e shkencave shoqërore dhe serinë e shkencave të zbatuara.
6. Procesi i botimit të Buletinit Shkencor realizohet nga Bordi Shkencor dhe Redaksia e Buletinit Shkencor.

Neni 2

Bordi Shkencor

1. Bordi Shkencor është organi shkencor që drejton procesin e realizimit të Buletinit Shkencor, shumica e anëtarëve të të cilit është personel akademik me kohë të plotë i UNIKO-së, kategoria “Profesorë”.
2. Bordi Shkencor përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë me titullin akademik “Profesor”, zëvendësrektorët, dekanët e fakulteteve, nga një përfaqësues për çdo fakultet të UNIKO-së i cili është personel akademik me kohë të plotë me titullin akademik “Profesor i asociuar”, si dhe nga profesorë të huaj apo shqiptarë që nuk janë pjesë e universitetit. Përfaqësuesit e fakulteteve me titullin akademik “Profesor i asociuar” vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Profesorët e huaj apo shqiptarë që nuk janë pjesë e universitetit propozohen nga departamenti dhe, pasi kanë dhënë pëlqimin, miratohen nga Senati Akademik për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Bordi Shkencor kryesohet nga rektori i Universitetit “Fan S. Noli”.
4. Bordi Shkencor mbledhet si rregull një herë në vit. Bordi Shkencor merr në analizë gjithë punën e kryer për botimin e Buletinit Shkencor, miraton udhëzimet për autorët, formatin e thirrjeve për botim etj.. Në mbledhjen e analizës vjetore të Bordit Shkencor marrin pjesë edhe anëtarët e Redaksisë së Botimeve.
5. Mbledhja e Bordit Shkencor thirret nga kryetari i Bordit Shkencor, por edhe me kërkesen e mbi 50% të anëtarëve që janë pedagogë me kohë të plotë në universitet.
6. Bordi Shkencor miraton listën e recensuesve që do të kryejnë recencat e punimeve. Në këtë listë bëjnë pjesë të gjithë pedagogët me kohë të plotë të UNIKO-së që kanë grada ose tituj shkencorë si dhe personalitete të tjera me grada ose tituj shkencorë jashtë universitetit që

propozohen nga një departament dhe që japin pëlqimin e tyre. Emrat e recensuesve renditen sipas titullit shkencor dhe gradës, sipas fushës së tyre të studimit.

7. Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Bordit Shkencor përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit.
8. Mbarimi para kohe i mandatit të anëtarit të Bordit Shkencor bëhet nga Senati Akademik në rastet kur çënohet rëndë imazhi i Buletinit Shkencor nga veprimi ose mosveprimi i anëtarit.

Neni 3

Redaksia e Buletinit Shkencor

1. Redaksia e Buletinit Shkencor përbëhet nga kryeredaktori, redaktorët e fushave studimore, specialisti i botimeve dhe specialisti i marrëdhënieve me jashtë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Botimeve dhe Bibliotekës Shkencore.
 - 1.1. Specialisti i botimeve pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Botimeve dhe Bibliotekës Shkencore është edhe redaktor i gjuhës shqipe.
 - 1.2. Specialisti i marrëdhënieve me jashtë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Botimeve dhe Bibliotekës Shkencore është edhe redaktor i gjuhës angleze.
2. Zëvendësrektori për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor është kryeredaktor i Redaksisë së Buletinit Shkencor. Kryeredaktori udhëheq veprimtarinë e Redaksisë, komunikon me redaktorët dhe vendos së bashku me ta pranimin për botim të artikujve, pas kryerjes së recencave.
3. Redaktorët e fushave studimore janë pedagogë me kohë të plotë të UNIKO-së që mbajnë grada ose tituj shkencorë, nga një i tillë për secilën nga fushat studimore si:
 - a) Shkencat natyrore;
 - b) shkencat matematike dhe informatike;
 - c) shkencat bujqësore;
 - d) shkencat ekonomike;
 - e) shkencat humane;
 - f) shkencat filologjike;
 - g) shkencat e edukimit;
 - h) shkencat e shëndetit human.
4. Ata vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Nëse ndonjërit prej tyre i mbaron mandati para kohe, zgjidhet zëvendësi i tij për periudhën e mbetur me të njëjtën procedure.
5. Redaksia e Buletinit Shkencor mblidhet si rregull një herë në vit. Mbledhja e Redaksisë së Buletinit Shkencor thirret nga kryeredaktori, por edhe me kërkesën e mbi 50% të anëtarëve të tij.
6. Kryeredaktori në bashkëpunim me redaktorin e fushës përkatëse zgjedhin dy recensuesit për kontrollin e artikullit të dorëzuar për botim. Zgjedhja bëhet sipas radhës së pritjes në listën e renditur të recensuesve.
7. Renditja e artikujve për botim bëhet sipas datës së aprovimit të tyre për botim.
8. Specialisti i botimeve pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Botimeve dhe Bibliotekës Shkencore është edhe sekretar i Redaksisë së Buletinit Shkencor. Ai merr pjesë në të gjitha

mbledhjet e Redaksisë së Buletinit Shkencor dhe të Bordit Shkencor dhe mban procesverbalin përkatës.

9. Mënyra e shpërblimit të anëtarëve të Redaksisë së Buletinit Shkencor përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit.

Neni 4

Dorezimi i punimit nga autorët

1. Artikulli dorëzohet prej autorit ose autorëve në adresën buletini@unkorce.edu.al. Specialisti i botimeve pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Botimeve dhe Bibliotekës Shkencore merr në dorëzim dorëshkrimet nga autorët dhe i kontrollon, nëse janë në përputhje me kriteret për botim, si dhe kontrollon për ngjashmërinë, të përcaktuar nga Neni 10. Nëse punimi plotëson kriteret për botim dhe ato të përcaktuara nga Neni 10, specialisti ia përcjell punimin kryeredaktorit. Në qoftë se rezulton se punimi nuk plotëson ndonjë nga kriteret, ia kthen autorit ose autorëve për plotësim.
2. Punimi kërkimor vlerësohet prej kryeredaktorit dhe redaktorit të fushës përkatëse, nëse është i përshtatshëm për serinë përkatëse të Buletinit Shkencor dhe, nëse i përshtatet fokusit dhe qëllimit të revistës. Në të kundërt, artikulli i kthehet autorit për rregullime ose artikulli nuk pranohet.

Neni 5

Procesi i kontrollit shkencor të punimit

1. Çdo artikull do të vlerësohet në mënyrë të pavarur nga dy recensues, të cilët përzgjidhen nga kryeredaktori dhe redaktori i fushës përkatëse nga lista e aprovuar e renditur e recensueseve të Buletinit Shkencor të fushës përkatëse sipas radhës, bazuar në përzgjedhjen paraardhëse. Preferohet që njëri prej tyre të jetë me titullin akademik “Profesor”. Recensuesi nuk mund të jetë redaktor dhe as autor ose bashkëautor i punimit.
2. Recensuesve u vihet në dispozicion një formular rishikimi, i cili do të plotësohet në mënyrë të pavarur nga recensuesit me vlerësimet përkatëse për artikullin. Emri i recensuesit mbahet i fshehtë për autorin apo autorët e artikullit dhe emri i autorit apo i autorëve të artikullit mbahet i fshehtë për recensentin.
3. Vlerësimet e recensuesve më pas i dërgohen autorit përkatës nga redaktori i fushës për te njoftuar rezultatin e vlerësimit.

Neni 6

Vendimi për botimin e punimit

1. Pas procesit të rishikimit nga autorët, kryeredaktori do të marrë njërin nga katër llojet e vendimeve editoriale, bazuar në rekomandimet e recensuesve:
 - a) Artikulli i pranuar: Artikulli do të pranohet pa rishikime.

- b) Kërkohen rishikime: Artikulli do të pranohet pasi të jenë bërë ndryshime të vogla. Në këtë rast, vendimi, nëse ndryshimet janë ato të duhurat, i mbetet redaktorit të fushës përkatëse.
 - c) Kërkohen rishikime të thelluara: Artikulli duhet të ripunohet, por me ndryshime të rëndësishme, ai mund të pranohet. Megjithatë, do të kërkojë një raund të dytë rishikimi nga recensentët.
 - d) Refuzohet pranimi: Artikulli nuk do të botohet në Buletinin Shkencor.
2. Kryeredaktori i Buletinit Shkencor do t'ia dërgojë vendimin përfundimtar autorit përkatës. Nëse vendimet e recensentëve për pranimin apo refuzimin përfundimtar të artikullit janë të ndryshme, kryeredaktori me redaktorin e fushës përkatëse marrin vendimin për botimin e artikullit.
 3. Nëse artikulli pranohet për botim, kryeredaktori autorizon specialistin e botimeve pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Botimeve dhe Bibliotekës Shkencore të bëjë montimin përfundimtar të artikullit, i cili e hedh atë në faqen e internetit të buletinit, pasi është bërë më parë redaktimi në shqip dhe në anglisht i artikullit.
 4. Mënyra e shpërblimit të recensuesve dhe tarifrat e publikimit për autorët përcaktohen me vendim të Bordit të Administrimit.

Neni 7

Kohëzgjatja e veprimeve për kontrollin e artikullit

Kohëzgjatja nga momenti i dorëzimit me sukses të artikullit deri në botimin e tij elektronik do të jetë 2 (dy) muaj, sipas proceseve vijues:

- a) Kohëzgjatja e kryerjes së recensës nga recensentët – 1 (një) muaj;
- b) Kohëzgjatja e rishikimit të punimit nga autorët – 2 (dy) javë;
- c) Kohëzgjatja e kontrollit të rishikimit nga recensentët 1 (një) javë;
- d) Kohëzgjatja e montimit dhe hedhja në faqen e internetit 1 (një) javë.

Neni 8

Hapja dhe përfundimi i thirrjes për botim

Thirrja për botim qëndron në fuqi gjatë gjithë vitit kalendarik. Në fund të vitit kalendarik bëhet botimi i buletinit në hard copy sipas serive të tij.

Neni 9

Tirazhi i Botimit

Tirazhi i Buletinit Shkencor përcaktohet nga Redaksia e Buletinit Shkencor. Nga ky numër, 2 (dy) kopje nga secila seri i dorëzohen secilës prej bibliotekave të fakulteteve të UNIKO së, si dhe bibliotekës shkencore të UNIKO-së dhe nga 1 (një) kopje nga secila seri i dërgohen bibliotekave të universiteteve shqiptare publike ose jopublike.

Neni 10

Politika e plagjiaturës

1. Revista është rreptësisht kundër çdo akti joetik të kopjimit apo plagjiaturës së çdo lloji. Vetë plagjiatura ndodh kur një autor përdor një pjesë të madhe të punës së tij ose të tjerëve të botuar më parë pa përdorur referencat e duhura.
2. Kontrolli i ngjashmërisë do të bëhet 2 (dy) herë për çdo artikull, së pari përpara kontrollit nga recensentët dhe së dyti, para botimit duke përdorur TURNITIN Similarity Check ose ndonjë softëare tjetër të ngjashëm që përcaktohet nga Bordi Shkencor.
3. Artikujt e kontrolluar me TURNITIN Similarity Check duhet të kenë një indeks ngjashmërie më të vogël se 20%. Artikujt do t'u kthehen autorëve nëse indeksi i ngjashmërisë është më i madh se 20%. Autorët mund të rishikojnë artikujt për të përmbushur kërkesat e Buletinit Shkencor në lidhje me ngjashmërinë. Artikujt e ridorëzuar do të kalojnë sërish në procesin e rishikimit dhe, nëse indeksi i ngjashmërisë është sërish mbi 20%, redaksia përkatëse do t'i refuzojë artikujt.

Neni 11

Etika e publikimit

Të gjitha palët e përfshira në procesin e botimit të Buletinit Shkencor, anëtarët e Bordit Shkencor, anëtarët e Redaksisë së Buletinit Shkencor, recensuesit dhe autorët, duhet të kuptojnë dhe respektojnë normat dhe etikën e botimeve shkencore. Publikimi i artikujve në Buletin Shkencor duhet të udhëhiqet nga politika të bazuara në procedurat dhe praktikat më të mira të kërkimit shkencor. Punimet shkencore për botim duhet të ruajnë në thelb tre vlerat etike të botimit:

- a) Neutraliteti, i cili është i lirë nga konfliktet e interesit në menaxhimin e botimeve;
- b) Drejtësia, e cila u jep të drejtën e autorit mbajtësve të së drejtës së autorit;
- c) Ndershmëria, e cila është e lirë nga kopjimet, fabrikimet, falsifikimi dhe plagjiatura.

Neni 12

Miratimi dhe ndryshimi i rregullores

Kjo rregullore miratohet dhe ndryshohet me vendim të Senatit Akademik.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon rregulloren e mëparshme dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

REKTORI

Prof.dr. Lorenc Ekonomi



UDHËZUES PËR AUTORËT/ TEMPLATE

TITULLI (TIMES NEË ROMAN, CAPITAL, BOLD, 10, CENTER)

Emri Mbiemri¹, Emri Mbiemri², (Times Neë Roman, Italic, 9, Center)

¹Universiteti, Fakulteti, Adresa e institucionit, email (Times Neë Roman, 9, Center)

²Universiteti, Fakulteti, Adresa e institucionit, email (Times Neë Roman, 9, Center)

Abstrakti (Times New Roman, Bold, 10 pt, Left)

Abstrakti nuk duhet të kalojë 250 fjalë (përafërsisht 15 rreshta). Në të duhet të bëhet një përmbledhje e shkurtër e qëllimit të punimit, metodologjisë së përdorur, rezultateve kryesore dhe përfundimeve. Abstrakti nuk duhet të përmbajë referenca dhe shkurtime. Abstrakti duhet të shkruhet në Times Neë Roman, Italic, 12, single space, Justify.

Abstrakti duhet të pasohet nga fjalët kyçe, jo më shumë se 6 fjalë të ndryshme nga fjalët e përdorura në titull, të shkruara në Times Neë Roman, italic, 10.

Fjalët kyçe: *fjala, fjala, fjala...*

- Dorëshkrimi mund të shkruhet në gjuhën shqipe ose gjuhën angleze. Në rast se materiali është shkruar në gjuhën shqipe, titulli dhe abstrakti duhet të jenë të shkruara fillimisht në shqip dhe më pas në anglisht. Nëse i gjithë materiali është i shkruar në anglisht, duhet që titulli dhe abstrakti të shkruhen edhe në versionin shqip.

- Dorëshkrimi duhet të shkruhet në Times Neë Roman, 12, font size dhe me hapësira midis rreshtave "Line spacing" = single.

- Dorëshkrimi dorëzohet në format të printuar dhe elektronike.

- Versioni i printuar dorëzohet pranë Sekretarisë së Këshillit Botues, Biblioteka Shkencore, Godina e Rektoratit. Versioni elektronik duhet të jetë në formatin .pdf dhe në formatin .doc ose .docx. Dorëshkrimi duhet të dërgohet në adresën e emailit: buletini@unkorce.edu.al

- Materiali i plotë duhet të përfshijë në një total prej rreth 10 faqesh tekstin, materialin grafik dhe tabelat së bashku me dixhiturat përkatëse, si dhe listën e referencave.

Titulli i Nënseksionit 1 Në rast kur seksioni i nivelit të parë shoqërohet me nënseksion, titulli i nënseksionit (nënseksion i nivelit të parë) duhet të shkruhet me Times Neë Roman, 12, Bold, shkronja e parë e çdo fjale, kapitale, të tjerat të vogla.

Titulli i Nënseksionit 2 (italic, shkronja e parë e çdo fjale kapitale, të tjerat të vogla).

- Përdorimi i shkurtimeve: në artikull mund të përdoren shkurtime, kuptimi i të cilave duhet të jetë sqaruar në përdorimin e parë.

MATERIALET

Në këtë çështje përshkruhen të dhënat e nevojshme për studimin e kryer, diskutimet e fundit ndërkombëtare në fushën përkatëse të studimit, motivimin, qëllimin dhe pyetjet e kërkimit.

METODOLOGJIA E PËRDORUR

Kjo çështje shpjegon metodologjinë e përdorur në realizimin e studimit. Shpjegimi i metodologjisë duket të jetë i hollësishëm, i qartë.

REZULTATET

- Rezultatet duhet të jenë të qarta dhe konçize.
- Dixhiturat e figurave: duhen paraqitur nën çdo figurë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, bashkë me referimet përkatëse.

Figurat dhe Tabelat (Times Neë Roman, italic, 11, Center)

Figurat (ku përfshihen grafikët dhe fotografitë) dhe tabelat duhet të përfshihen në tekst, në vendin e duhur dhe nuk duhet të dalin përtej përmasave të faqes. Figurat, fotot, grafikët duhet të jenë të kualitetit të lartë për të qenë sa më të dukshme në versionin e printuar të Buletinit. Ato duhet të pozicionohen në qendër. Figurat dhe tabelat duhet të renditen sipas rendit numerik: Figura 1, Figura 2...etj dhe Tabela 1, Tabela 2...etj. Emërtimet e tabelave dhe figurave vendosen në pjesën e sipërme të tyre, burimi i të dhënave duhet të vendoset në pjesën e poshtme, në qendër, me të njëjtin model shkrimi. Shkrimi në brendësi të tabelave duhet të jetë Times Neë Roman, 11, normal. Burimi i të dhënave të tyre duhet të listohen në listën e Referencave. Njësitë e përdorura duhet të jenë në përputhje me ato të Sistemit Ndërkombëtar të Njësiave.

DISKUTIMI I REZULTATEVE

Diskutimet duhet të interpretojnë të dhënat e rezultateve të punës, por pa i përsëritur ato, si dhe krahasimin e të dhënave të studimit me studimet e mëparshme.

PËRFUNDIME

Në këtë paragraf përmblihen rezultate e punës dhe nxirren konkluzionet, jepen rekomandimet përkatëse.

REFERENCAT(Times Neë Roman, 11, single-spaced)

- Referencat duhen cituar brenda në tekstin kryesor në formatin sipas rasteve të mëposhtme:
 - a) kur kemi vetëm një autor p.sh. (Mosteller, 1949), pra, mbiemri i autorit, viti i botimit, Ndërsa artikulli i cituar tek referencat do të shkruhet në trajtën: Mosteller, F. (1949), "Questions and answers", *American Statistician*, 3, 12-13. Pra, mbiemri i autorit, iniciali i emrit. (viti i botimit), "Titulli i artikullit", *Emri i revistës në italic*, Numri i revistës, numrat e faqeve të parë dhe të fundit të artikullit.
 - b) Për referencën e një artikulli me dy autorë kemi p.sh. (Bunge dhe Fitzpatrick, 1993), pra mbiemrat e autorëve, viti i botimit. Ndërsa artikulli i cituar tek referencat do të shkruhet në trajtën: Bunge, J. dhe Fitzpatrick M. (1993), "Estimating the number of species: A review", *Journal of the American Statistical Association*, 88, 364-373.
 - c) Për referencë me më shumë se dy artikuj kemi p.sh. (Deming dhe Glasser 1959, Goodman 1952, Kish 1965, Sudman 1976).
 - d) Një libër i cituar do të shkruhet tek referencat në trajtën: mbiemri i autorit, iniciali i emrit. (viti i botimit), *titulli i librit në trajtën italic*, qyteti, shtëpia botuese. Për shembull Sarndal, C. E., Sëensson, B. dhe Èretman, J. (1992), *Model-Assisted Survey Sampling*, Neë York, Springer-Verlag.
 - e) Një punim i një konference i cituar, tek referencat, do të jetë në trajtën. Selinger, P. G., Astrahan, D. D, Chambelain, R. A., Lorie R. A. Dhe Price, T. G. (1979), "Access Path Selection in a Relational Database Management System", in *Proceedings of the 1979 AACM SIGMOND International Conference on Management of Data*, 23-34.
- Referencat në listën e referencave renditen sipas rendit alfabetik, ku i pari në radhë është artikulli me i vjeter nga pikepamja kronologjike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË

E-mail: buletini@unkorce.edu.al

Datë: __/__/__

DEKLARATË PËR TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË AUTORIT PËR PUBLIKIM

(Hartuar në referencë të nenit 4, nenit 8, pika 1/h, nenit 14, nenit 21, nenit 29, pika i, dhe nenit 48 të Ligjit Nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to")

Veprimtaria: BOTIM NË BULETININ SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

Titulli i punimit:

Fusha e studimit:

(specifikoni një nga fushat e poshtëshënuara)*

Autori/ët e punimit me titullin e mësipërm deklaron/jnë se:

- 1- Punimi është punë e tij/tyre origjinale;
- 2- Autori/ët e punimit ka/kanë përgjegjësi publike për punimin;
- 3- Autori/ët pranon/jnë që punimi të dorëzohet për botim;
- 4- Autori/ët pranon/jnë që punimi të botohet në ëbsite-in e Universitetit;
- 5- Punimi nuk është botuar më parë dhe nuk është dorëzuar për botim diku tjetër;
- 6- Teksti, ilustrimet dhe çdo material tjetër i përdorur nuk cënon të drejtën e pronësisë së askujt;
- 7- Transferimin e të drejtës së autorit për botim të punimit me titullin e mësipërm tek Buletini Shkencor i Univesitetit "Fan S. Noli" Korçë, të cilit i njohim të drejta të plota për botim dhe përhapjen e tij.¹

Autori me të cilin do të mbahet korrespondenca¹:

Emër/Mbiemër: (date. _____)

Tel:E-mail:

Autorë të tjerë: _____ (dt. _____)

*01 Shkencat natyrore

02 Shkencat matematike dhe informatike

03 Shkencat bujqësore

04 Shkencat ekonomike

05 Shkencat humane

06 Shkencat filologjike

07 Shkencat edukative

08 Shkencat e shëndetit human

¹ Kjo deklaratë duhet të firmoset nga të gjithë autorët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

Adresa: Shëtitorja "Rilindasit"

E-mail: buletini@unkorce.edu.al

FORMULAR I RECENSENTIT PËR VLERËSIMIN SHKENCOR TË PUNIMIT PËR BOTIM NË
BULETININ SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

Titulli i punimit:

Data e recencës:

Recensenti: (titulli/gradë Emër Mbiemër)

1. KOMENTE SPECIFIKE

Përmbajtja	E ulët	Mesatare	E lartë
Rëndësia e punimit			
Origjinaliteti / Risia			
Vlera praktike / Impakti			
Përshatja e titujve dhe e nëntitujve			
Qartësia e hyrjes			
Përshatshmëria e metodës eksperimentale			
Qartësia e gjetjeve dhe e diskutimit			
Konkluzionet			
Referencat dhe citimi			
Fjalët çelës dhe abstrakti			
Përdorimi i gjuhës: gabimet gramatikore dhe drejtshkrimore			

Forma	E ulët	Mesatare	E lartë
Organizimi i punimit			
Gjatësia e punimit			
Përshatshmëria e gjuhës			
Terminologjia			
Cilësia e figurave/tabelave/grafikeve			

Vlerësimi i punimit:

2. REKOMANDIMI PËRFUNDIMTAR

Pranohet	
Pranohet me rishikime të vogla	
Pranohet me rishikime të mëdha	
Refuzohet / Nuk pranohet	

Recensenti

UDHËZIME PËR PLOTESIMIN E FORMULARIT TE RECENSËS

Për recensuesin:

Plotësoni tabelat duke vendosur X në qelizën përkatëse sipas vlerësimit tuaj. Tek vlerësimi i punimit ju mund të shkruani komente mbi vlerësimin e punimit, të cilat argumentojnë vlerësimet tuaja dhe i tregojnë autorit në mënyrë më të qartë ndryshimet që duhet t'i bëjë.

Për autorin.

-Në rastin kur vlerësimi përfundimtar i recensës është "Pranohet" punimi kalon direkt në procesin e botimit.

-Në rastin kur vlerësimi përfundimtar i recensës është "Pranohet me rishikime të vogla", punimi u kthehet autorëve dhe, pasi ata kryejnë ndryshimet, redaktori i fushës vendos për botimin.

- Në rastin kur vlerësimi përfundimtar i recensës është "Pranohet me rishikime të mëdha", punimi u kthehet autorëve dhe, pasi ata kryejnë ndryshimet, recensenti duhet të vlerësojë punimin përsëri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

Adresa: Shëtitorja "Rilindasit"

E-mail: buletini@unkorce.edu.al

DEKLARATË

Për reflektimin e sugjerimeve të ekspertëve të vlerësimit shkencor

Veprimtaria: Reflektimi i sugjerimeve të ekspertëve të vlerësimit shkencor në artikullin e dorëzuar për botim në "Buletin Shkencor", botim i Universitetit "Fan S. Noli".

Titulli i punimit:.....

Fusha e studimit:.....

Autori/ët e punimit me titullin e mësipërm, pasi janë njohur me vlerësimin e recensuesve, deklaron/jnë se kanë vendosur ta rivlerësojnë punimin duke reflektuar në artikull sugjerimet e ekspertëve të dala nga procesi *peer review* sipas ndryshimeve të mëposhtme:

Autori/ët e punimit me titullin e mësipërm deklaron/jnë se kanë vendosur ta paraqesin përsëri për botim artikullin pasi kanë reflektuar sugjerimet në fjalë

Autori me të cilin do të mbahet korrespondenca:

Emër/Mbiemër:

Tel:

E-mail:

(dt. _____)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

Adresa: Shëtitorja "Rilindasit"

E-mail: buletini@unkorce.edu.al

FORMULAR I RECENSENTIT PËR VLERËSIMIN SHKENCOR TË PUNIMIT PËR BOTIM NË
BULETININ SHKENCOR TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" PAS RISHIKIMIT NGA AUTORET

Titulli i punimit:

Data e recencës:

Recensenti: (titulli/grada Emër Mbiemër)

Komente mbi rishikimin e autorëve:

REKOMANDIMI PËRFUNDIMTAR

Pranohet	
Refuzohet / Nuk pranohet	

Recensenti

Për recensentin dhe autorin: Nëse vendimi i të dy recensentëve është "Pranohet", artikulli kalon në procesin e botimit, nëse vendimet e recensentëve janë të ndryshëm vendimin për botimin ose jo e merr kryeredaktori së bashku me redaktorin e fushës dhe nëse të dy recensentët marrin vendimin "Refuzohet", artikulli nuk pranohet për botim.

Udhëzime Etike për Publikimin e Buletinit Shkencor

Artikujt kalojnë përmes një procesi verifikimi nga recensuesit që është i rëndësishëm për zhvillimin e një grupi njohurish koherente dhe të respektueshme. Kjo është një formë e njohjes së cilësisë së artikujve të autorit dhe institucioneve që qëndrojnë pas tyre. Rishikimi i artikujve është një formë aplikimi dhe mishërimi i metodës shkencore. Prandaj, është e rëndësishme të bien dakord mbi standardet e pritshme të sjelljes etike për të gjitha palët e përfshira në veprimet botuese: autorët, redaktorët, recensentët dhe botuesit. Redaksia, redaktorët, i kuptojnë detyrat e tyre si përgjegjës në çdo proces, si në aspektin etik ashtu edhe në përgjegjësi të tjera.

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e redaktorëve

- a) Drejtësia: Pavarësisht nga ngjyra e autorit, gjinia, orientimi seksual, pikëpamjet fetare, përkatësia etnike, kombësia ose pozicioni politik i autorit, vlerësimi i redaktorëve për dorëshkrimin duhet të bazohet vetëm në përmbajtjen intelektuale të vetë artikullit.
- b) Konfidencialiteti: Kryeredaktori dhe çdo redaktor nuk lejohen t'i zbulojnë asnjë informacion në lidhje me dorëshkrimin e dorëzuar dikujt tjetër përveç autorit, recensuesit, bashkëredaktorit dhe botuesit.
- c) Zbulimi dhe konflikti i interesit: Informacioni i pabotuar i shpalosur në tekstin e dorëzuar nuk mund të përdoret në kërkimin e vetë redaktorit pa autorizimin e shprehur të autorit.
- d) Vendimi për botim: Kryeredaktorit dhe redaktorët janë përgjegjës për të vendosur se cilët artikuj duhet të publikohen nga artikujt që janë dorëzuar. Vlefshmëria dhe përfitimet e artikujve për studiuesit dhe lexuesit duhet të përdoren si një faktor përcaktues në çdo vendim. Redaktorët do t'i bazojnë politikën e tyre në bordin editorial të revistës dhe rregullat ligjore përgjithësisht të zbatueshme si shpifja, shkelja e të drejtës së autorit dhe plagjiatura. Redaktorët mund të negociojnë me redaktorë të tjerë ose rishikues të tjerë përpara se të marrin këto vendime.
- e) Vlerësimi i dorëshkrimit: Çdo dorëshkrim duhet të kontrollohet për origjinalitet nga redaktori përpara se të pranohet. Redaktorët duhet të organizojnë dhe përdorin vlerësimet e recensuesve në mënyrë të drejtë dhe inteligjente. Redaktori duhet t'i shpjegojë autorit procesin e rishikimit nga kolegët. Për dorëshkrimet e konsideruara për botim, redaktorët duhet të përdorin recensues të përshtatshëm, duke përzgjedhur individë me përvojën e nevojshme dhe duke i vlerësuar në mënyrë anonime.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e recensuesit

- a) Kontributet në vendimet editoriale: Recensuesit ndihmojnë redaktorët e fushave në marrjen e vendimeve editoriale dhe gjithashtu ndihmojnë autorët përmes rekomandimeve për të përmirësuar cilësinë e artikujve.
- b) Përpikëri: Pasi të caktohet, një recensues që mendon se i mungojnë aftësitë e kërkuara për të vlerësuar një artikull të caktuar ose që parashikon që vlerësimi i tij nuk do të përfundojë në kohë duhet të informojë redaktorin e fushës dhe të tërhiqet nga procesi i rishikimit të artikullit.
- c) Standardi i objektivitetit: Rishikimi duhet të kryhet në mënyrë të paanshme. Është joetike të kritikosh autorin personalisht. Rishikimet duhet të jenë koncize dhe të arsyetuara mirë, përveç nëse redaktori i fushës ose kryeredaktori në mënyrë specifike udhëzon ndryshe.
- d) Konfidencialiteti: Çdo artikull i dërguar recensuesit për shqyrtim duhet të trajtohet si një dokument konfidencial. Pa lejen e redaktorit të fushës, dorëshkrimet nuk mund të shfaqen apo diskutohen me të tjerët.
- e) Njohuri për burimet e referencës: Citimi duhet të tregojë botimet përkatëse që autori nuk i ka cituar. Recensuesit duhet gjithashtu të informojë redaktorin e fushës nëse artikulli në shqyrtim dhe çdo punë e botuar më parë për të cilën ata janë në dijeni kanë ndonjë mbivendosje ose ngjashmëri të rëndësishme.
- f) Konfidencialiteti dhe Konflikti i Interesit: Çdo ide ose informacion i marrë përmes rishikimit nga kolegët kërkohet të mbahet konfidencial dhe të mos përdoret për përfitime personale.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Autorit

- a) Standardi i të shkruarit: Autorët duhet të paraqesin raporte të sakta të hulumtimit të kryer si dhe objektivat dhe përfitimet e kërkimit. Të dhënat bazë duhet të përfaqësohen me saktësi në artikullin e dërguar. Dorëshkrimi duhet të përmbajë detaje dhe referenca të mjaftueshme për të lejuar të tjerët të përsërisin ose vazhdojnë kërkimin. Akti i mashtrimit ose pasaktësia e qëllimshme në paraqitjen e të dhënave dhe referencave është sjellje joetike dhe e papranueshme.
- b) Originaliteti dhe plagjiatura: Autorët duhet të sigurohen që vepra e tyre të jetë plotësisht origjinale dhe nëse kanë përdorur fjalët ose veprën e dikujt tjetër, duhet të sigurohen që ajo të jetë cituar saktë.
- c) Dorëzimi i një artikulli në më shumë se një revistë: E njëjta punë kërkimore nuk mund të botohet nga i njëjti autor në më shumë se një

revistë (publikim i shumëfishtë ose i njëkohshëm). Është joetike dhe e papërshtatshme që autorët të dorëzojnë njëkohësisht të njëjtin punim në disa revista.

- d) Njohja e burimit: Autori duhet të njohë gjithmonë kontributet e autorëve të tjerë. Shkrimtarët duhet të citojnë vepra që kanë pasur ndikim në mënyrën se si është shkruar vepra e tyre shkencore.
- e) Cilimi i autorit: Duhet të citohen vetëm ata që kanë dhënë një kontribut të madh në konceptimin, hartimin, zbatimin ose interpretimin e hulumtimit të paraqitur. Bashkautorë duhet të emërohen vetëm ata që kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në konceptimin, projektimin, zbatimin ose interpretimin e hulumtimit të paraqitur duhet të citohen si autorë. Ata individë që kanë kontribuar në një element thelbësor të studimit duhet të njihen ose të citohen si kontribues. Autorët duhet të sigurojnë që të gjithë bashkëautorët të kenë shqyrtuar versionin përfundimtar të artikullit dhe ta kenë miratuar atë përpara se ta paraqesin për botim.
- f) Gabimet domethënëse në veprat e botuara: Kur autori gjen gabime ose pasaktësi domethënëse në veprat e vetëbotuara, është detyrë e autorit të njoftojë menjëherë redaksinë ose botuesin e revistës dhe të bashkëpunojë me redaktorin për të rikujtuar ose korrigjuar artikullin. Është përgjegjësi e autorit t'i raportojë redaktorit ose botuesit për çdo gabim ose pasaktësi në veprat e vetëbotuara dhe të punojë me redaktorin për të tërhequr ose korrigjuar artikullin.